



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.998/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Arsim Hamzaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.Z. nga Ferizaj rr. "...", të cilin me autorizim e përfaqëson R.SH. av. nga Ferizaj, rr. "...", p.nr, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson I.L., me objekt të padisë pagesë e shpërblimit jubilar me rastin e pensionimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.131/19, i datës 13.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më **28.09.2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Kaçanikut- Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.131/19, i datës 13.11.2019, **VËRTETOHET**, përveç pjesës për kamatën e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet me kamatë ligjore prej 8 %, e cila llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 13.11.2019, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.131/19 të datës 13.11.2019, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit I.Z. nga Ferizaj. Në pikën e dytë të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të shpërblimit jubilar, me rastin e pensionimit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 438.42 €, me kamatë sipas mjeteve të depozituara në bankat komerciale për një vit pa destinim të caktuar, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën e tretë të dispozitivit, gjykata ka obliguar të

paditurin, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 378.00€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të se drejtës materiale dhe më këtë ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që të hedhet poshtë kërkesëpadia e paditësit dhe të priset aktgjykimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është **e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padinë e parashtruar ka kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të pagës jubilarë të paguaj shumën prej 438.42 € me kamatë prej 8 % nga data e deponimit të padisë deri të pagesa përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave si në vijim: vërtetimi me nr. 04.nr.610/01-14082/19, i dt.08.05.2019, vendimi 04-nr.113-20617-11/2015, i datës 30.06.2015, lista e pagave për muajin gusht 2017, si dhe vendimi për daljen në pension i datës 20.10.2017, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimi të atakuar gjykata ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura deri në momentin e pensionimit me datë 02.04.2018 si dhe paditësi ka përvojë pune te e paditura mbi 30 vite, kjo duke u bazuar në vendimin nr.113-20617-11.2015, i datës 30.06.2015 me të cilin gjithashtu i është njohur e drejta në shpërblim jubilar . Duke u bazuar në Kontratën Kolektive për të Punësuarit në Arsim Fillor dhe të Mesëm neni 35 par.8 nën par.8.3 parasheh që *“punëtorët që kanë arritur vitet e përvojës së punës , përfitojnë pagesë të shpërblimit jubilar sipas mesatares të tri pagave të fundit të punëtorit”* ndërsa sipas nenit 35 par 8 nën par 8.3, 8.5 dhe par 8.6 i Kontratës Kolektive punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimin jubilar, ndërsa shpërblimi jubilar paguhet me rastin e 7 marsit çdo vit, çka do të thotë se pala e paditur e ka pasur obligim që t'ia bëjë pagesën palës paditëse. Sipas kësaj, pala paditëse me të drejtë ka kërkuar pagesën e shpërblimit jubilar.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe

rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si përvoja e punës së paditësit tek e paditura, si dhe lartësia e pagës, nuk kanë qenë kontestuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve.* Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”. Ndërsa me nenin 52 paragraf 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se: *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”.* Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje për caktohet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”*, ndërsa në paragrafin 3 përcaktohet se: *“Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj një pagë në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e lidhur me date 18.03.2014, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), të cilat kontrata kanë hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, ndërsa paditësi padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 17.06.2019, çka do të thotë se këto marrëveshje – kontrata (edhe kontrata sektoriale e arsimit që ka hyrë në fuqi në vitin 2017), kanë qenë në fuqi

në momentin e pensionimit dhe se të njëjtat janë në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedh edhe themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449, 450, 452.2 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveç për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të kamatës, duke e gjykuar kamatën prej 8 %, të llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë. 04.07.2018, e deri në pagesën definitive, në bazë të nenit 382.2 të LMD-së (*pasi që gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar dispozitive të LMD-së së vitit 1978, edhe pse raporti juridik në mes palëve kontraktuese është krijuar në muajin nëntor të vitit 2013, ku në fuqi ka qenë LMD-ja e vitit 2012, përkatësisht Ligji Nr.04/L-077, mirëpo kjo nuk ka pasur ndikim në vendosjen e kësaj çështje kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së dytë*).

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor të palës së paditur, që ka të bëjë me afatshmërinë e padisë, mirëpo erdhi në përfundim se i njëjti nuk qëndron. Kjo për faktin se në rastin konkret kërkesa e paditësit ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave pas pensionimit, e që në fakt në rastin konkret zbatohet neni 87 i Ligjit të Punës që parasheh afat 3 vjeçar për parashtrimin e padisë në raste të tilla. Në rastin konkret, marrëveshja e përgjithshme kolektive, por edhe ajo sektoriale e arsimit, prodhojnë efekt juridik vetëm për të ardhmen, përkatësisht nuk kanë efekt prapaveprues, kështu që referuar shkresave të lëndës rezultoi se pala paditëse ka parashtruar padi në gjykatë brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.998/20, datë 28.09.2020

Kryetari i kolegjit

Lumni Sallauka